

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës

dhe

Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë

Tiranë, më 16 Korrik 2018,

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës dhe Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë (më tutje referuar si Palët), shprehin vullnetin e tyre për të bashkëpunuar mbi bazën e mirëbesimit dhe , mirëkuptimit reciprok, pasqyruar kjo përmes këtij Memorandum Bashkëpunimi.

Palët angazhohen për të shkëmbyer informacionet dhe përvojat respektive në fushën e sigurimeve.

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit të Bashkëpunimit

Qëllimi i këtij Memorandumi është mbrojtja e interesave të kompanive të sigurimit, promovimi i integritetit, stabilitetit dhe efikasitetit të industrisë së sigurimeve dhe vendosja e formave të bashkëpunimit ndërmjet palëve, për të përmirësuar veprimtaritë respektive të interesave që ato përfaqësojnë, mbi bazën e parimeve të barazisë dhe paanësisë.

Neni 2

Kërkesat dhe Ekzekutimet

1. Kërkesat e palëve në këtë Memorandum do të paraqiten me shkrim ndaj personave kontaktues përgjegjës. Në raste urgjente, kërkesat mund të paraqiten shkurtimisht dhe më pas do të ndiqen me kërkesën e plotë.
2. Pala, së cilës i është bërë kërkesa, do ta trajtojë atë në kohën më të përshtatshme.
3. Çdo kërkesë do të vlerësohet nga pala përkatëse nëse informacioni i kërkuar mund të ofrohet brenda kornizave të këtij Memorandumi. Në çdo rast, kur kërkesa nuk pranohet si e plotë, pala ndaj të cilës është paraqitur kërkesa do të konsiderojë nëse mund të ketë ndonjë informacion relevant apo të pjesshëm, për të cilin mund të ofrohen shpjegimet e nevojshme.
4. Çdo dokument apo material i ofruar si përgjigje ndaj kërkesës në kuadër të këtij Memorandumi dhe çdo kopje e tij duhet t'i kthehet palës që ka dhënë informacionin, sipas kërkesës së saj.

Neni 3

Përdorimi i lejuar dhe Konfidencialiteti

1. Përputhshmëria me detyrimet mbi sekretin profesional të të gjithë të punësuarve dhe zyrtarëve të cilët pranojnë informacionin nga shteti tjetër, është një kusht i domosdoshëm për bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet palëve.
2. Secila palë do të mbajë konfidencial çdo informacion që është miratuar në këtë Memorandum nëse nuk është paraqitur në mbështetje të qëllimit për të cilin është bërë kërkesa.
3. Të gjitha informacionet e miratuara sipas këtij Memorandumi janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen ose transferohen nga njëra palë në një palë të tretë pa pëlqimin e palës tjetër.

4. Pala kërkuese mund të përdorë informacionin vetëm për qëllimin e shprehur në kërkesë. Nëse pala kërkuese synon të përdorë informacionin e paraqitur për ndonjë qëllim tjetër, do duhet të kërkojë pëlqim paraprak të palës tjetër.

Neni 4 Bashkëpunimi teknik

1. Palët tentojnë të punojnë së bashku për të identifikuar dhe adresuar, në varësi të disponibilitetit të personelit dhe burimeve njerëzore, asistencë trajnuese dhe teknike për të lehtësuar zhvillimin e tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe në Kosovë.
2. Palët mund të zgjerojnë dhe të lehtësojnë shkëmbimin e njohurive, eksperiencën dhe ekspertizën midis përfaqësuesve të Palëve dhe ku është e përshtatshme midis institucioneve të tjera relevante të përfshira në çështjet e mbikëqyrjes së sigurimeve.
3. Bashkëpunimi i përshkruar më sipër mund të marrë formën e çdo aktiviteti si më poshtë:
 - Pjesëmarrja në seminare, trajnime, grupe pune dhe konferenca në vendin e secilës palë;
 - Vizita konsultative të ekspertëve të Palëve përkatëse;
 - Shkëmbimin e praktikave të mira dhe të dokumentacionit;
 - Çdo formë tjetër e bashkëpunimit që mund të vendoset reciprokisht;

Neni 5 Personi i Kontaktit Përgjegjës

1. Të gjitha komunikimet midis Palëve duhet të bëhen midis personave përgjegjës të kontaktit, të caktuar nga palët.
2. Zbatimi i dispozitave të këtij Memorandumi duhet të jetë i përputhur me ligjet kombëtare dhe rregulloret e shteteve të palëve respektive dhe nuk duhet të jetë në kundërshtim me interesat publike të shtetit të çdo njërit prej Palëve.

Neni 6 Aplikueshmëria e Memorandumit

1. Ky Memorandum do të shërbejë si bazë për bashkëpunim ndërmjet palëve. Ky Memorandum nuk ka për qëllim krijimin e detyrimeve ligjore, e as të tejkalojë ndonjë kërkesë ligjore apo rregullative në fuqi në Kosovë apo në Shqipëri. Ky Memorandum nuk prodhon asnjë të drejtë të ekzekutueshme për palët e treta.
2. Hyrja në fuqi e përcaktimeve sipas këtij Memorandumi do të jetë në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të secilit shtet dhe nuk do të jetë në kundërshtim me interesin publik të asnjë shteti të palëve.
3. Çdo palë do të mbaje shpenzimet e veta që shkaktohen nga çdo formë e bashkëpunimit apo asistencës bazuar në kërë Memorandum. Megjithatë, çdo palë mund të mbulojë kostot financiare të palës tjetër, duke u bazuar në vendimin e tij vullnetar dhe në respektim të

legjislacionit përkates kombëtar, nëse këto kosto janë krijuar nga bashkëpunimi mbi bazën e këtij Memorandumi.

Neni 7

Hyrja në fuqi dhe ndryshimet e Memorandumit

1. Ky Memorandum lidhet pa një afat të caktuar dhe është i vlefshëm për sa kohë që të dy palët të kenë interes të përbashkët.
2. Ky Memorandum hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve.
3. Palët do të zgjidhin në mënyre miqësore çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi

Neni 8

Përfundimi

1. Ky Memorandum do të mbetet në fuqi derisa njëra nga palët të njoftojë palën tjetër me shkrim se do të rishikojë, ndryshojë apo tërhiqet nga ky Memorandum. Secila palë mund të përfundojë këtë Memorandum duke njoftuar me shkrim palën tjetër. Memorandumi do të quhet i përfunduar 3 muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga pala tjetër.
2. Ndërpreja i këtij Memorandumi nuk do të ndikojë në kërkesat e palëve për informacionet të cilat janë bërë dhe nuk janë përmbushur para datës efektive të përfundimit. Në të njëjtën kohë kushtet mbi ruajtjen e informacionit të konfidencialitetit do të jenë në fuqi.

Ky Memorandum përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 16 /07/2018

Në emër të
Shoqatës së Sigurimeve të Kososës

Z. Sami Mazreku
Drejtor Ekzekutiv



Në emër të
Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë

Zj. Fitnete Sulaj
Kryetare

